



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0511-A0001

Në çështjen juridike të:

Paditësi

A Sh- i përfaqësuar nga B K B, - Prishtinë.

Kundër:

E paditura/ankuesja

N.SH "Auto Prishtina" (në likuidim), Prishtinë, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-15-0693, të datës 19 gusht 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, me shumicë lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e të paditurës është e bazuar.**
- 2. Anullohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS, C-IV.-15-0693 i datës 19 gusht 2022.**
- 3. Lënda kthehet në rigjykim në Shkallë të parë të DHPGJS tek gjyqtari përkatës.**

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 29 prill 2015, paditësi kishte parashtruar padi në DHPGJSK, kundër të paditurës AKP-së, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e tij dhe të detyrohet e paditura që t'ia kompensojë shumën 14,370.00 euro, në emër të kompensimit dhe pagave të pa paguara për periudhën nga tetori i vitit 2003 e deri në qershor të viti 2014, si punëtor i NSH "Auto Prishtina" (në likuidim). Paditësi në padi ka theksuar se ka qenë i punësuar pranë NSH-së "Auto Prishtina" dhe se pala e paditur me shkresën me numër të protokollit 15373, ishte njoftuar për fillimin e procesit të likuidimit të Ndërmarrjes i cili ka filluar me datën 21.07.2014. Po ashtu është njoftuar edhe për anulimin e të gjitha kontratave të punës të cilat deri atëherë kanë qenë në fuqi. Më datën 12 qershor 2014 se bashku me të punësuarit e tjerë në ndërmarrje nëpërmjet menaxhmentit dhe kryesisë së sindikatës kishin depozituar një regjistër e cila përmbante emrin dhe mbiemrin e secilit të punësuar në ndërmarrje, pagat mujore, akontacionet e marra nga NSH-ja, dhe pagat që kishin mbetur të pa paguara për periudhën nga tetori 2013 e deri në qershor 2014, gjegjësisht 130 muaj. Paditësi kishte theksuar se në mes të menaxhmentit, këshillit drejtues dhe sindikatës në njërën anë dhe ndërmarrjeve private me pronarë B S ishin krijuar raporte të dëmshme për NSH dhe se menaxhmenti në bashkëpunim me palën e paditur nuk kishin arritur t'i normalizojnë këto raporte, si rezultat i këtyre raporteve pala paditëse është dëmtuar me mos pagesë të pagave për periudhën nga tetori 2003 e deri në qershor 2014. Në vazhdimësi ka kërkuar kompensimin e pagave mujore sipas kontratës së punës deri në njoftimin në lidhje me procesin e likuidimit të ndërmarrjes. Pran Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar kërkesë brenda afatit ku ka kërkuar kompensimin, mirëpo Autoriteti i likuidimit e ka refuzuar kërkesën për kompensimin e pagave edhe përkundër faktit se kërkesa ka qenë e parashtruar brenda afatit dhe ka pasur prova të mjaftueshme. Paditësi në padi i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tersi si të bazuar kërkesën e tij dhe të detyrohet pala e paditur që palës paditëse t'ia paguajë borxhin-pagat e pa paguara për periudhën nga tetori 2003 e deri në qershor 2014 , në shumën e përgjithshme

prej 14,370.00 euro me normë të kamatës prej 3.5 % në vit. Padiësi ankesës i ka bashkangjitur: Numrin e regjistrimit të përkohshëm të subjektit afarist 80077394 të SH.A "Auto Prishtina", njoftimin drejtuar AKP-së për ushtrimin paditës kundër AKP-së, 2 njoftime të AKM-së drejtuar B S të vitit 2004, një listë të punëtorëve aktiv dt 12 qershor 2014, të cilët nuk i kanë marrë pagat për 130 muaj sipas kontratës së punës, kontratën e punës të vitit 2003, autorizimin për përfaqësim nga avokati dhe një deklaratë të tij.

Më 30 mars 2022, Shkalla e I-rë e Dhomës së Posaçme ka lëshuar Urdhër veç e veç si për të akuzuarin ashtu edhe për AKP-në.

Për të akuzuarin e paditësin është kërkuar të plotësohet padia e ushtruar në lidhje me pagimin e pagave të pa paguara për periudhën e muajit tetor 2003 deri në muajin qershor të vitit 2014 dhe ju është kërkuar të sqarohet saktë në lidhje me pretendimin sipas tij se ka ushtruar kërkesë kreditore në procedurë të likuidimit pranë AKP-së. Ndërsa për AKP-në është kërkuar të jep përgjigje në mbrojtje në padinë e padiësit dhe të dorëzon të gjitha provat ne të cilat mbështeten argumentet.

Më 13 prill 2022 padiësi dorëzoi parashtresën në përgjigje ndaj Urdhrit të dt. 30 mars 2022, me të cilin është deklaruar se padiësi posedon me Vendimin e NSH "Auto Prishtina" PRN 126-0185, e regjistruar në AKP 2470/2015, me të cilin kërkesa e paraqitur nga padiësi për kompensimin e pagave të mbetura të pa paguara në shumën 14,950.00 euro refuzohet. Padiësi ishte deklaruar se posedon edhe Vendimin PRN 126-0187, me të cilin është pranuar kërkesa për dëmshpërblimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë 242,16 euro. Po ashtu është deklaruar se të paditurës AKP-së ju është dorëzuar lista e punëtorëve të cilët nuk i kanë marrë pagat sipas kontratës së punës më 12 qershor 2014. Padiësi parashtresës ja ka bashkangjitur; vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN 126-0185, të datës 31 mars 2015, dëshminë e ankesës kundër vendimit PRN 126-0187, të datës 29 prill 2015 dhe Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN0126-0187 të datës 29 prill 2015, kontratën e punës të datës 10 tetor 2003 dhe deklaratën për

zyrën Rajonale të AKP –së në Prishtinë. Lista e punëtorëve aktiv të cilët nuk i kane marrë pagat sipas kontratës së punës të datës 12 shtator 2014, në të cilën paditësi është në listën me nr.34.

Më 21 prill 2022, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës së paditësit theksoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit duke i konsideruar të pa bazuar në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohet dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. E paditura theksoi se NSH, "Auto Prishtina" ka hyrë në procedurën e likuidimit më 21 korrik 2014, më datën 11 shtator 2014, pala paditëse pranë saj ka parashtruar kërkesë me të cilën ka kërkuar kompensimin e pagav të pa paguara në shumën prej 14,950.00 euro. Autoriteti i Likuidimit me vendimin PRN126-0185, të datës 31 mars 2015, e ka refuzuar kërkesën e parashtruar nga paditësi në atë procedure. Ka shtuar se Autoriteti i Likuidimit e ka marrë vendimin për refuzimin e kërkesës duke u bazuar në nenin 36.2 1 Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 dhe nenit 608 të ligjit për punën e Bashkuar (i aplikueshëm sipas nenit 1 të rregullores së UNMIKUT 199/24 është përcaktuar se pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tri vite.

E paditura kishte theksuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se saktë i ka zbatuar edhe dispozitat ligjore. E paditura thekson se pretendimet e paditësi janë parashkruar ngase nuk ka asnjë prove që para Autoritetit të Likuidimit, parashtruesi ka dorëzuar kërkesë pranë gjykatës apo organit tjetër kompetent nga shtator i vitit 2003. Ka shtuara se paditësi nuk ka parashtruar prova që e mbështetë pretendimin se ka kërkuar kompensimin e borxhit të pretenduar dhe se nuk ka parashtruar padi në gjykatë apo organi tjetër kompetent.

Më 11 maj 2022, Dhoma e Posaçme e gjykatës Supreme përsëri ka lëshuar për paditësin Urdhër C-IV.-15-0693, për tu deklaruar në parashtrësë të paditurit me date 21 prill 2022, ashtu që të jep përgjigje në pretendimin e të paditurit në lidhje me parashkrimin e kërkesës, sikundër edhe të dorëzon të gjitha provat për pagat e pa paguara që arsyeton shumën e kërkuar 14.370.00.

Më 27 prill 2022, i autorizuari i paditësit dorëzoi parashtresën dhe i njëjti është deklaruar në lidhje me çështjen e parashkrimit të kërkesës kreditore, ashtu që ka theksuar se e paditura për çdo muaj punëtorëve u ka paguar shumën nga 85.00euro, si pjesë e pagës mujore deri në fillimin e procedurës së likuidimit më 27 korrik 2014 , me të cilin veprim edhe është ndërprere përshkrimi në vazhdimësi dhe qe pala paditëse për shkak të mos përmbushjes së borxhit ka ushtruar padi. Në lidhje me llogaritjen e pagave i autorizuari ka theksuar se është regjistri i punëtorëve të datës 12 qershor 2014, ku paditësit ju është llogaritur paga dhe ju është pranuar borxhi. Paditësi në parashtresë është deklaruar se e kundërshton pretendimin e të paditurës për parashkrim duke u mbështetur në nenin 368 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, që parasheh,, Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin, pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veq se edhe në mënyre të tërthorte, sikundër janë pagesat e kësteve” që është rasti i pagesave të akontacionit prej 85.00 euro, secilit të punësuar për çdo muaj duke i deklaruar të punësuarit se borxhi për paga do tua paguaj të punësuarit pas fillimit të likuidimit të NSH-së. Pra e paditura i ka pranuar pagat në tersi. Se padia është e bazuar në fakte dhe prova mund të konfirmohet edhe sipas parashtresës e cila iu kishte adresuar personalisht drejtorit të NSH,, Auto Prishtina” I S i cili është edhe përpilues dhe nënshkrues i listës së të punësuarve aktiv.

Më 19 gusht 2022, Shkalla e parë e DHPGJSK-së kishte marrë Aktgjykim C-IV-15-0693, me të cilin aprovet si e bazuar kërkesëpadinë e paditësit A Sh dhe ndryshohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN126-0185, ashtu që e paditura NSH ,, Auto Prishtina”, paditësit për periudhën prej tetorit të vitit 2003 deri në qershor të vitit 2014, t’ia paguajë pjesën e pagave të pa paguara në shumën 14,370.00 euro, sipas nenit 40 paragrafi 1, pika 1.7, të Shtojcës së Ligjit, nr.04/L034. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se duke u bazuar në listën e punëtorëve aktiv, të cilët nuk i kanë marrë rrogat sipas kontratës së punës, nr.4 të datës 12 qershor 2014, e nënshkruar nga drejtori I S dhe Kryetari i këshillit të punëtorëve, R C për NSH,, Auto Prishtina” vërtetohet fakti se kjo listë përfshin 38 punëtor dhe me të njëjtën listë jepen të dhëna për rrogën mujore, akonacion mujor, pjesa

rrogës mujore e pa realizuar periudha kohore tetor 2003 deri në qershor të vitit 2014, ose për 130 muaj. Sipas kësaj liste paditësi kishte pagën mujore në lartësi 200.00 euro që përputhet edhe me kontratën e punës 10 tetor 2003, me nenin 5 sipas të cilës paga ishte caktuar në shumën 200.00 euro për punë, pastaj fakti se paditësit si akontacion i është paguara për çdo muaj shuma shuma 85.00 euro për këtë periudhë kohore si në kërkesë, sikurse të gjithë punëtorëve të tjerë, pa dallim pozite dhe lartësie të pagës, ndërsa borxhi për pjesën e pagës së pa realizuar për çdo muaj është në shumë 115.00 euro.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se duke marrë për bazë faktin se e paditura nuk ka kundërshtuar këtë dokument si prove mbi bazën e se cilës është kërkuar kërkesa për pagesën e pagave, si për përdhën tetor të vitit 2003 deri në qershor të vitit 2014, ashtu edhe për lartësinë në shumën 14,370.00 euro. Pavarësisht nga fakti se me Vendimin e PRN126-0185, paditësit ju ishte refuzuar kërkesa në shumën 14,950.00 euro, në rastin konkret, Gjykata provën e listës së Punëtorëve aktiv, të cilëve nuk ishte paguar paga sipas kontratës së punës nr.4, të datës 12 qershor 2014, e pranoi si prove të besueshme mbi bazën e se cilës mbështete kërkesa e paditësit, por pa u leshura edhe në vlerësimin e lartësisë së kërkesës, sepse shuma e kërkesës sipas padisë është më e ulët se shuma e kërkesës që është refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se në kohën kur paditësit i kanë arritur kërkesat për pagesën e shumës mujore si kompensim pagë, për periudhën prej vitit 2003 deri në dhjetor të vitit 2010 gjegjësisht të vitit 2012, si Ligj i punës në fuqi ka qenë rregullorja nr.2001/27, për Ligjin Themelore të Punës në Kosovë, si dhe Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve (LMD i RSFJ i vitit 1978), që ka rregulla të përgjithshme në lidhje me parashkrimin e kërkesave, ndërsa për kërkesat e paditësit pas dhjetorit të vitit 2010, gjegjësisht të vitit 2012 e deri në qershor të vitit 2014 si Ligj në fuqi i punës i Republikës së Kosovës nr.03/L212, dhe Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Republikës së Kosovës, nr.04/L-077. Shkalla e I-rë ka konstatuar se nisur nga fakti se dokumenti me të cilin është pranuar borxhi për punëtorët aktiv të NSH-së, për pagat e pa paguara është nënshkruar më 12 qershor 2014, atëherë me këtë dokument edhe është ndërprerë rrjedha e parashkrimit, për rastin konkret gjykata vlerëson se si i zbatueshëm është Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve i

Republikës Kosovës, nr.04/L-077, duke marrë për baze datën e lëshimit të dokumentit. Shkalla e I-rë po ashtu ka konstatuar se nisur nga fakti se kërkesa kreditore e paditësit, është ushtruar me datën 11 shtator 2014 te Autoriteti i Likuidimit, ndërsa dokumentacioni i lëshuar nga drejtori i të paditurës I S më 12 qershor 2014 me të cilin është pranuar borxhi, vlerëson se ky dokument ka prodhuar efekt juridik në lidhje me pranimin e borxhit si për paditësin si për punonjësit ashtu edhe për të paditurën si punëdhënëse, sepse ky dokument është lëshuar para datës së fillimit të procedurës së likuidimit sipas vendimit të Bordit të AKP-së date 21 korrik 2014. Kjo pikëpamje mbështet në nenin 368 paragrafi 1, Ligji për Marrëdhëniet e detyrimeve i Republikës së Kosovës, nr.04/L077.

Shkalla e I-rë ka arsyetuar se me pranimin borxhit nga e paditura edhe është ndërprere parashkrimi, kështu që pas ndërprerjes së parashkrimit më 12 qershor 2014, më 11 shtator 2014 është ushtruar kërkesa kreditore e paditësit te AL, që do të thotë se në rastin konkret nuk është i qëndrueshëm pretendimi i të paditurës për përshkrimin e borxhit, gjegjësisht borxhi nuk është parashkruar. Shkalla e I-rë ka tutje ka arsyetuar se Autoriteti i likuidimit ka konstatuar se në mënyre të gabuar faktin se është parashkruar kërkesa dhe si rrjedhojë e kësaj ka zbatuar në mënyre të gabuar edhe dispozitën e nenit 36.2.1, të shtojcës së Ligjit nr.04/L034.

Më 7 shtator 2022, AKP-ja /ankuesja ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit të Shkalla e I-rë C-IV-15-0693 të datës 19 gusht 2022, me të cilin ka propozuar që te ndryshohet aktvendimi i Shkallës së I-rë në pajtim me Nenin 9.10 të ligjit 06/L-086 duke refuzuar Ankesën e paditësit ndaj Vendimit PRN126-0185 të datës 31 mars 2015 si te pa bazuar dhe te vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja në ankesën e parashtruar ka theksuar se autoriteti i likuidimit e ka refuzuar kërkesën për paga të pa paguara të kantatës së punës për parashtruesin pasi ky rezulton të mos ishte aktiv në momentin kur fillon likuidimi- ky i fundit një veprim i ndërmarrë nga AKP-ja sipas nenit 6.2 Rrjedhimisht duke qenë se nuk ishte në marrëdhënie pune aktive me NSJH-në, në momentin kur NSH-ja hyri në likuidim, nuk kishte se si marrëdhënia e tij e punës të ndërpritej nga një veprim i ndërmarrë

nga agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të ligjit nr.04/L034. AKP fton DHPGJS që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë.

Më 12 dhjetor 2023, Kolegji i Apelit këtë ankesë e ka dërguar tek paditësi për përgjigje. Në përgjigjen e datës 09 janar 2024, paditësi nëpërmjet përfaqësuesit i kundërshton pretendimet e e të paditurës e cila kishte potencuar se paditësit i ishte refuzuar kërkesa për pagat e pa paguara pasi që paditësi nuk ishte aktiv në momentin kur kishte filluar likuidimi i NSH-së, kjo nga Vendimi i autoritetit të Likuidimit PRN-126-0184 të datës 12 maj 2015, kërkesa për pagat e pa paguara, paditësit i është refuzuar duke u bazuar ne nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L034 lidhur me nenin 608 të Ligjit për punën e bashkuar, e që lidhej me çështjen e parashkrimit te kërkesës e jo nëse paditësit ishte aktiv në momentin likuidimit ose jo. Po ashtu paditësi nëpërmjet përfaqësuesit ka potencuar se sa i përket faktit se paditësi a ka qenë aktiv apo jo përvës qe nuk qëndrojnë janë edhe te habitshme dhe kontradiktorë, kjo ngase vetë paditura përkatësisht autoriteti i likuidimit me Vendimin PRN 126-0187 të datës 29 prill 2015 kishte aprovuar kërkesën e paditësit që kishte te bënte me dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme te kontratës se punës, duke ia pranuar paditësit shumën prej 242, 16 euro përkatësisht 3 paga mujore për 11.43 vite përvojës se punës në pune). Paditësi thekson se në arsyetim te vendimit janë pohor pothuajse te gjitha faktet faktet te cilat ne ketë procedure gjyqësore e paditura i ka ngritur si pretendime, pasi qe një punëtor qe nuk është aktiv ne momentin e likuidimit nuk do te mund ti takonte e drejta në tri paga te dëmshpërblimit te demit për ndërprerjen te parakohshme t ë kontratës se punës, pra me ketë vendim e paditura Autoriteti i likuidimit i ndërmarrjes pohon edhe faktin se te njëjtit si pasoje e likuidimit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, gjë për të cilën ishte njoftuar edhe përmes parashtresës, sikurse që ishin njoftuar të gjithë punonjësit e NSH,, Auto Prishtina”. Andaj përmes këtij vendimi paditësit i janë njohur edhe kontributet tjera qe burojnë nga marrëdhënia e punës që nënkupton se paditësi nga e paditura është trajtuar si punonjës i rregullt, se paditësi ishte aktiv në momentin kur filloi likuidimi, dëshmohet edhe përmes Kontratës se punës e cila ishte me kohe te pa caktuar,

lista e punëtoreve aktiv e datës 12 qershor 2014, librezat e punës, rezultoni se paditësi ishte punonjës aktiv i punëtoreve në NSH deri më 21 korrik 2014.

Gjithashtu përmes vendimit të sipërshtënëuar të datës 29 prill 2015 e paditura ka pohuar edhe faktin se paditësi ka pranuar rrogën ndonëse e njëjta ishte akonacion mujor), gjë e cila e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës konform dispozitave të LMD lidhur me ndërprerje e parashkrimit, kjo pasi që menaxhimet e NSH "Auto Prishtina", ka marrë parasysh gjendjen në të cilën gjendej ndërmarrja (që ishte ishin të uzurpuara që e paditura kishte dështuar në lirim të tyre. Krejt në fund i ka propozuar Kolegjit të Apelit që ta refuzojë ankesën e të paditurës si të pabazuar dhe ta vërtetë Aktgjykimin e Shkallës së I-rë C-IV.-15-0693.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi më 11 shtator 2014 kishte paraqitur kërkesë pranë AL, përmes të cilës kërkoi kompensimin për paga të pa paguara në shumën prej 14,950.00 euro për periudhën tetor 2003 deri në qershor 2014 nga N.SH "Auto Prishtina" (Në likuidim). Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Më 29 prill 2015, paditësi ka parashtruar në DHPGJS-së padi kundër Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN126-0185 të datës 31 mars 2015 me të cilën ishte

refuzuar kërkesa kreditore për kompensimin e pagave të pa paguara nga N.SH "Auto Prishtina".

Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-15-0693, e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit A Sh, e ka ndryshuar Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN126-0185, ashtu që e ka obliguar të paditurën NSH ,, Auto Prishtina", që paditësit për periudhën prej tetorit të vitit 2003 deri në qershor të vitit 2014, t'ia paguajë pjesën e pagave të pa paguara në shumën 14,370.00 euro, sipas nenit 40 paragrafi 1, pika 1.7, të Shtojcës së Ligjit për AKP, nr.04/L034.

E paditura në procedurën ankimore e ka kundërshtuar aktgjykimin e Shkallës së I-rë, dhe ka theksuar se kërkesa e paditësit për pagat të papaguara është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Ajo rithekson se paditësi ka dështuar të paraqet prova në gjykatë se ai i ka kërkuar pagat e papaguara brenda 3 viteve, nga koha kur NSH nuk i ka paguara pagat paditësit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij dhe me parashtresën e dt. 02 shtator 2022, të dorëzuar në Shkallen e I-rë ka bashkangjitur: numrin e regjistrimit të përkohshëm të subjektit afarist 80077394 të SH.A "Auto Prishtina", njoftimin drejtuar AKP-së për ushtrimin paditës kundër AKP-së, 2 njoftime të AKM-së drejtuar B S të vitit 2004, një listë të punëtorëve aktiv të dt. 12 qershor 2014, të cilët nuk i kanë marrë pagat për 130 muaj sipas kontratës së punës, kontratën e punës të vitit 2003, autorizimin për përfaqësim nga avokati dhe një deklaratë të tij.

Kolegji i Apelit, vëren se nga Lista e punëtorëve aktiv të dt. 12 qershor 2014, gjendet edhe paditësi në nr. rendor 34 dhe se pagat e paguara përfshin periudhën prej tetorit 2003 deri në qershor 2014, në shumë prej 14,950.00 euro. Kjo Listë vërehet se është nënshkruar nga drejtori i NSH-së I S dhe Kryetari i këshillit të punëtorëve, R C për NSH,, Auto Prishtina".

Kolegji i Apelit vëren se asetet e NSH-së "Auto Prishtina" në Prishtinë në vitin 2000, nga autoritetet e UNMIK-ut ishin dhënë me qira një kompanie private. Paditësi nuk

është e qartë nëse ka punuar në këtë kompani private që i kishte marrë asetet e NSH-së me qira, sepse nga kontrata e punës të cilën paditësi e ka sjellë në gjykatë nuk është nënshkruar nga autoritet përgjegjëse të NSH-së, por nga mençmenti i ndërmarrjes private, andaj në rigjykim Shkalla e I-rë duhet ta vërtetoj këtë fakt, në atë mënyrë që pastaj të konstatohet se kush ka për obligim ti përmbush pagat e papaguara të pretenduara nga paditësi.

Kolegji i Apelit po ashtu vëren se Shkalla e I-rë ka nxjerr konstatimin e gabuar që kërkesa e paditësit për paga si e tëra nuk është parashkruar, pasi që siç shihet nga shkresat e lëndës një pjesë e tyre është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë ka konstatuar se kërkesa për paga për periudhën tetor 2003 deri qershor 2014 nuk është parashkruar dhe i ka njohur paditësit shumën e kërkuar, duke u bazuar në dokumentacionin e lëshuar nga drejtori i të paditurës I S më 12 qershor 2014 (Lista e punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marr rrogat sipas kontratës) dhe ka vlerësuar se ky dokument ka prodhuar efekt juridik në lidhje me pranimin e borxhit si për paditësin ashtu edhe për të paditurën si punëdhënëse dhe se me këtë dokument edhe është ndërprerë rrjedha e parashkrimit.

Kolegji i Apelit udhëzon që në rigjykim Shkalla e I-rë, të rishikoj nëse se Lista e punëtorëve aktiv e dt. 12 qershor 2014 e lëshuar nga NSH, a ka mundur të ndërpres parashkrimin e pagave për të cilën tani me ka lindur parashkrimi, apo vetëm ato të cilat nuk janë parashkruar. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve si Ligj që ishte në fuqi (LMD i RSFJ i vitit 1978) tek rregullat e përgjithshëm në lidhje e me parashkrimin në nenin 362 shprehimisht parasheh se parashkrimi lind kur të ketë skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj.

Kolegji i Apelit vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet, madje edhe te Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 690 i datës

30 mars 1978 (neni 372, paragrafi 1) dhe te Ligji i ri (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së).

Prandaj, Kolegji i Apelit vlerëson se ankesa e të paditurës është e bazuar mbi arsyet e cekura më lartë dhe Aktgjykimi i ankimuar nuk është saktë dhe i drejtë e si i tillë duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim në Shkallë të I-rë.

Andaj në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, në shumë prej 100 euro, me datë 23 shtator 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
